



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE
KOMISIONI I PROVIMEVE TË AFTËSIVE PROFESIONALE**

**Zbatimi në praktikë i kërkesave të legjislacionit të tatimeve dhe taksave
në Republikën e Shqipërisë.**

25 Qershor 2018

Seksioni 1

**Pyetje me alternativa (1 pikë secila).
Zgjidhni alternativën e saktë.**

1. Legjislacioni tatimor përbëhet nga:

- a) marrëveshjet ndërkombëtare, të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë;
- b) ligjet tatimore;
- c) aktet nënligjore, të miratuara në mbështetje të ligjeve tatimore.
- d) të treja.

Përgjigja e saktë alternativa D

2. Kontrolli tatimpaguesve bëhet me miratim të:

- a) Drejtorit të Kontrollit Tatimor;
- b) Drejtorit të Përgjithshëm të tatimeve;
- c) Drejtorit të Auditit.
- d) Drejtorit të Hetimit Tatimor.

Përgjigja e saktë alternativa B

3. Rikontrolli tatimor mund të kryhet në rastet kur:

- a) tatimpaguesi nuk ka bashkëpunuar gjatë kontrollit tatimor ose nuk ka vepruar, në përputhje me kërkesën me shkrim, për t'i dhënë informacion administratës tatimore, gjatë kryerjes së kontrollit tatimor;
- b) administrata tatimore ka prova, konkrete dhe të besueshme, që tatimpaguesi është përfshirë në evazion tatimor;
- c) inspektori, gjatë kontrollit tatimor, nuk ka vepruar në përputhje me procedurat dhe, për këtë shkak, ndaj tij kanë filluar procedura disiplinore apo janë marrë masa disiplinore.
- d) a), b) dhe c)

Përgjigja e saktë alternativa D

4. Tatimpaguesi, në deklaratën vjetore të të ardhurave, nuk jep të dhëna për të ardhurat bruto, per:

- a) shuma bruto të fituara nga lotari apo lojëra të tjera të fatit;
- b) të ardhurat bruto nga pasuria intelektuale, licencat, të drejtat ekskluzive dhe pasuri të tjera, që përbëhen vetëm nga të drejta dhe që nuk kanë formë fizike;
- c) të ardhura bruto të realizuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
- d) asnjëra

Përgjigja e saktë alternativa D

5. Në përcaktimin e fitimit të tatueshëm, nuk amortizohen:

- a) kostot e të rinovimit të ndërtesave;
- b) pajisje të ruajtjes së të dhënave;
- c) sendet antike;
- d) kostot e rikonstruksionit të ndërtesave.

Përgjigja e saktë alternativa C

6. Cilët janë elementet që përfshihen në vlerën e tatueshme për efekt të aplikimit të TVSH:

- a) uljet e çmimit për pagesa të menjëherëshme të kryera për furnizimin;
- b) uljet dhe reduktimet e çmimit të pasqyruara në faturë;
- c) shumat që ka marrë një person i tatueshëm nga ana e blerësit apo klientit të tij si rimbursim për shpenzimet;
- d) çmimi i produkteve të blera;

Përgjigja e saktë alternativa D

7. Kompania B operon një hotel turistik me 50 dhoma në Sarandë. Për efekt të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, furnizimi i shërbimit hotelier trajtohet si furnizim:

- a) I përjashtuar?
- b) Me shkallë 20%?
- c) Me shkallë 0%?
- d) Me shkallë të reduktuar 6%?

Përgjigja e saktë alternativa D

8. Individit A është i regjistruar si Person i Vetëpunësuar dhe njëkohësisht punon si administrator në shoqërinë B me pagë bruto mujore 150.000 Lekë. Cili nga pohimet e mëposhtëme është i saktë:

- a) Individit A paguan sigurime shoqërore dhe shëndetsore mbi pagën 24.000 Lekë si i vetëpunësuar;
- b) Individit A paguan sigurime shoqërore dhe shëndetësore mbi pagën 48.000 Lekë si i vetëpunësuar;

- c) Individi A paguan sigurime shoqërore dhe shëndetësore mbi pagën 150.000 Lekë në kompaninë B;
- d) Asnjëra nga pohimet e mësipërme.

Përgjigja e saktë alternativa D

9. Cili nga subjektet e mëposhtme përjashtohet nga taksat e tarifave vendore?

- a) Ambasadat;
- b) Pensionistët;
- c) Ato të parashikuara në ligje të veçanta;
- d) Strukturat akomoduese "hotel me katër/pesë yje me status special";
- e) Shoqëritë publike shtetërore.

Përgjigja e saktë alternativa C

10. Përjashtohen nga Tvsh- e importit

- a) makineritë dhe pajisjet për investimet me vlerë më të madhe ose të barabartë me 50 milion;
- b) kafshët në majmëri;
- c) makineritë dhe pajisjet për investimet në sektorin e agro-biznesit;
- d) a), b) dhe c).

Përgjigja e saktë alternativa D

Seksioni II

Administrimi i detyrimeve tatimore në RSH, procedurat që zbatohen për mbledhjen e tatimeve dhe detyrimeve të tjera tatimore. Struktura e tatimeve dhe taksave. Autoritetet përgjegjëse të taksave në nivel kombëtar e vendor.

11. Përshkruani fushën e veprimit të ligjit “Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”.

5 pikë

Përgjigje:

Ligji zbatohet për:

- a) tatimpaguesit, administratën tatimore, agentët tatimorë, agentët e mbajtjes së tatimit në burim, si dhe për persona të tjerë, të përcaktuar nga legjislacioni tatimor;
- b) personat e ngarkuar për të paguar, mbajtur, deklaruar dhe transferuar në Buxhetin e Shtetit kontributet, për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore;
- c) personat që paguajnë kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, për sa u përket pagesës dhe mbledhjes së kontributeve;
- ç) sistemin e tatimeve, taksave dhe tarifave vendore, për aq sa nuk rregullohen me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.

12. Përshkruani parimet e administrimit të sistemit tatimor të Republikës së Shqipërisë nga të cilat udhëhiqet administrata tatimore.

5 pikë

Përgjigje:

Në administrimin e sistemit tatimor të Republikës së Shqipërisë administrata tatimore udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

- a) zbatimi i njëjtë dhe efektiv i legjislacionit nga ana e administratës tatimore;
- b) vetëvlerësimi dhe vetëdeklarimi i detyrimit tatimor nga ana e tatimpaguesit;
- c) nxitja e respektimit vullnetar të legjislacionit tatimor, nëpërmjet informimit, edukimit dhe publikimit të akteve nënligjore;
- ç) hartimi i strategjive dhe marrja e masave përkatëse për pakësimin e rreziqeve që rezultojnë nga mosrespektimi i legjislacionit tatimor;
- d) bashkëpunimi me organet tatimore vendase dhe ndërkombëtare, në funksion të globalizimit të ekonomive botërore;
- dh) ndjekja e ndryshimeve në mjediset e biznesit dhe atij legjislativ, si dhe përshtatja e sistemeve të organizimit të burimeve, të teknologjisë së informacionit dhe proceseve të punës, për arritjen e efikasitetit dhe të efektivitetit të duhur;
- e) nxitja e veprimtarive elektronike, sidomos të deklarimit dhe pagesës elektronike të detyrimit tatimor;
- ë) rekrutimi, trajnimi dhe ngritja në detyrë e punonjësve tatimorë, të ndershëm, të sjellshëm dhe të drejtë dhe që, për çdo rast, zbatojnë ligjin, aktet nënligjore dhe vendimet, në bazë të fakteve objektive.

13. Përshkruani dokumentacionin për mbajtjen e të dhënave dhe llogaritjen e detyrimit tatimor për tatimpaguesit në regjimin e tvsh-së.

5 pikë

Përgjigje:

1. Tatimpaguesit, që janë subjekt i TVSH-së ose i tatim-fitimit, për përlllogaritjen e detyrimit tatimor, mbajnë regjistrat, dokumentacionin kontabël, librat dhe informacionin financiar, si dhe lëshojnë faturë tatimore, dëftesë tatimore ose kupon tatimor, në përputhje me ligjet e fushës, si dhe aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të tyre.

2. Tatimpaguesi, subjekt i TVSH-së, regjistron menjëherë të gjitha veprimet financiare dhe përgatit e mban libra e regjistra kontabël, ku regjistrohen:

- a) shitjet e përditshme të mallrave ose kryerja e punimeve apo e shërbimeve të tatueshme, përfshirë shumën e secilit veprim dhe shumën e tatimit të ngarkuar;
- b) veprimet e përfunduara, por akoma të pafaturuara;
- c) veprimet e patatueshme;
- ç) pagesat për mallra dhe shërbime, përfshi shumën e secilës blerje apo pagesë, shumën e tatimit të paguar dhe emrin e adresën e furnizuesit.

3. Çdo blerësi, person fizik, juridik ose individ, i lind e drejta të mos kryejë transaksionin për vlerën e mallit ose shërbimit të ofruar, nëse shitësi nuk lëshon faturën tatimore ose kuponin tatimor, në përputhje me këtë ligj. Për këtë qëllim, tatimpaguesi detyrohet të afishojë në një vend të dukshëm, në adresën ku kryen veprimtarinë, një njoftim për blerësin.

14. Rakordimi të ardhurave për arkëtime me bankë

6 pikë

Më 31.12.2017 tatimpaguesi "Dajti" sh.p.k jep këto të dhëna për organet e kontrollit tatimor:

- Të ardhura të deklaruara në deklaratë së bashku me Tvsh 10.500.000 lekë
- Gjendje në bankë 10.800.000
- Klientë në fillim të ushtrimit (900.000)
- Klientë në fund 600.000
- 10.500.000

Treguesit e analizuar si një e tërë janë të pranueshëm dhe rakordojnë.

Grupi kontrollit nga kontrolli i dokumentacionit në subjekt konstaton:

- Të ardhura të deklaruara në deklaratë së bashku me Tvsh 10.500.000 lekë
- Gjendje në bankë 11.400.000
- Klientë në fillim të ushtrimit (900.000)
- Klientë në fund 840.000
- 11.340.000

Në këtë rast gjendja e llogarisë bankare nuk rakordon?

Përcaktoni shmangjen tatimore, kryeni vlerësim tatimor dhe zbatoni dënimin administrativ për shkeljen e konstatuar?

Përgjigje:

Shmangia tatimore :

- (1) Të ardhura ligjore sipas kontrollit 11.340.000 lekë.
- (2) Të ardhura sipas deklarimit të tatimpaguesit 10.500.000 lekë.
- (3) Shmangia tatimore (1-2) = 840.000 lekë

Shmangia tatimore 840.000 lekë

Vlerësimi tatimor: 840.000 lekë

Dënimi administrativ për fshehjen e të ardhurave tatimore 100% = 840.000 lekë

15. Gjatë një kontrolli që ushtrohet te tatimpaguesi “Drini” sh.p.k, konstatohet se deklarata e TVSH-së rezulton me detyrim tatimor të padeklaruara dhe të papaguar në vlerën 100,000 lekë. Periudha nga koha kur detyrimi tatimor duhej të paguhej dhe deri kur është konstatuar nga administrata tatimore është 400 ditë. Deklarata e tatimpaguesit është certifikuar nga kompani certifikuese audituese miratuar nga Ministria e Financave dhe vërtetohet se kjo deklaratë është në përputhje me legjislacionin fiskal.

Kërkohet:

- a) Përcaktoni sanksionet që duhet të llogariten dhe vlerën e sanksioneve
- b) Përcaktoni dhe përshkruani procedurat e konkurrimit për krijimin e listës së kompanive audituese/kompanive të klasifikuara si të tilla me ligj të veçantë që do të kenë të drejtë për certifikimin e deklaratave tatimore për pajtueshmëri me legjislacionin fiskal.

6 pikë

Përgjigje:

- a) Shkeljet e tatimpaguesi dhe denimi administrativ:

1- Mospagim në afat i detyrimit tatimor

Tatimpaguesi, i cili nuk paguan brenda afatit të parashikuar në ligj shumë e detyrimit tatimor, ose të kontributit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, detyrohet të paguajë një gjobë të barabartë me 0.06 % të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

$$0.06\% * 100.000 * 365 = \mathbf{21,900 \text{ lekë}}$$

2- Mosdeklarimi në afat

Tatimpaguesi, i cili nuk dorëzon në afatet e përcaktuara në ligjet e veçanta tatimore, deklaratën tatimore, dënohet me 10 (dhjetë) mijë lekë gjobë nëse është tatimpagues i tatimit mbi fitimin dhe me 5 (pesë) mijë lekë gjobë për çdo tatimpagues tjetër, për çdo deklaratë tatimore të padorëzuar në afat. Kjo gjobë vendoset vetëm një herë për çdo

deklaratë tatimore, pavarësisht nga zgjatja e vonesës, dhe ajo nuk ndikon në gjobën për pagesë të vonuar e cila llogaritet në bazë të nenit 114 të ligjit.

Ne rastet kur shkeljet e konstatuara janë pasoje e njëra tjetrës, te rrjedhura nga një shkelje baze, për një lloj tatimi, vendoset një dënim i vetëm që është dënimi me gjobën më të lartë i njërës nga shkeljet e mësipërme. Sa më sipër për tatimpaguesin vendoset gjoba për Mospagim në afat I detyrimit tatimor.

3-Kamatvonesa

Kur një person i tatueshëm nuk paguan shumën e plote të detyrimit tatimor brenda afateve të përcaktuara në ligjet e veçanta tatimore, ai detyrohet të paguaje kamatëvonesa mbi shumën e detyrimit tatimor të papaguar duke filluar nga data në të cilën pagesa ka qene e detyrueshme për tu paguar, deri në datën në të cilën pagesa kryhet. Kamatëvonesa për mospagimin e detyrimeve tatimore brenda afateve të përcaktuara, është 120 për qind e shkalles së interesit nderbankar të Bankës së Shqipërisë e cila shpallet nga kjo e fundit për çdo tremujor, në bazë të shkalles mesatare të një tremujori me pare.

4- Detyrimi tatimor i tatimpaguesit përfshin:

Tatimin, gjobat dhe kamatëvonesat.
100.000+ 21,900 + Kamatvonesen

b) Shkeljet e kompanise se çertifikuar

Në rast se nga kontrolli i bërë nga administrata tatimore të tatimpaguesit, deklaratat tatimore të të cilëve janë certifikuar nga kompanitë certifikuese, se janë në përputhje me legjislacionin fiskal, rezulton detyrim tatimor, kompania certifikuese dënohet me një gjobë, në masën 50 për qind të detyrimit tatimor të ngarkuar tatimpaguesit.

Gjoba= 50% *(100.000+ 21,900 + Kamatvonesen)

c) Procedura e konkurimit dhe çertifikimit të kompanive audituese

Për të fituar të drejtën për kryerjen e këtij shërbimi, kompanitë audituese/apo kompanitë e klasifikuara si të tilla, duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- i. Të jenë shoqëri të auditimit ligjor të publikuara në Regjistrin publik të EKR-ve të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar apo kompani të klasifikuara si të tilla me ligj të veçantë të regjistruara sipas kushteve të përcaktuara në ligj;
- ii. Të ketë përvojë në fushën e auditimit, kontabilitetit dhe këshillimeve tatimore;
- iii. Të kenë auditues ligjor me eksperiencë në rolin e ortakut.

Për të marrë pjesë në konkurrim, kompanitë audituese/ kompanitë e klasifikuara si të tilla me ligj të veçantë, duhet të plotësojnë disa kritere:

- Kriteri ligjor, vërtetimin me dokumente të faktit që subjekti aplikues plotëson këto dy kushte:
 - a) ka 10 vite përvojë në fushën e auditimit, kontabilitetit dhe këshillimeve tatimore;

b) ka të paktën një auditues ligjor në rolin e ortakut të angazhimit me përvojë pune jo më pak se 5 vjet;

- Të jetë e regjistruar në Regjistrin Publik të EKR-së të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar.
- Kriteri teknik: Historik i shkurtër dhe përshkrim i kompanisë audituese/ kompanisë të klasifikuar si të tillë me ligj të veçantë përfshirë një prezantim të stafit dhe kualifikimeve të tyre (CV);
- Kriteria të tjera: Deklaratë e Administratorit të shoqërisë se Shoqëria nuk do të kryejë shërbimin e verifikimit dhe certifikimit të deklaratave tatimore të një tatimpaguesi, në rastet kur ato, të punësuarit e tyre apo palët e lidhura me to, siç përcaktohet në Kodin e Etikës të IEKAs/ligjin e veçantë, i kanë dhënë tatimpaguesit shërbime të kontabilitetit, të konsulencës fiskale apo shërbime të tjera të ngjashme, në lidhje me përgatitjen e deklaratave tatimore.

Seksioni III

Tatimet Mbi të Ardhurat

- 16.** Cilat janë kriteret që duhet të plotësojnë shpenzimet për të qënë të njohura për efekt të tatimit mbi fitimin dhe cilat janë dokumentet bazë për justifikimin e tyre?

5 pikë

Përgjigje:

Shpenzime të njohura janë ato që kryhen për qëllime të biznesit, që synojnë sigurimin dhe ruajtjen e të ardhurave. Keto janë të gjitha shpenzimet (përfshirë shpenzimet e jashtezakonshme) e biznesit, me përjashtim të atyre që janë kryer me qëllim formimin dhe rritjen e kapitalit. Shpenzimet e njohura janë kryesisht shpenzime të destinuara për të ruajtur ekzistencën e kapitalit si burim i të ardhurave dhe për të siguruar në kohën e duhur riformimin apo zëvendësimin e kapitalit (p.sh amortizimi). Shpenzimet e njohura janë shpenzime që njihen si të zbritshme nga të ardhurat për përcaktimin e fitimit të tatueshëm. Për të qënë të njohura (të zbritshme) shpenzimet duhet të përmbushin këto kushte:

- a. të jenë kryer në interes të drejtëpërdrejtë të veprimtarisë ekonomike prej së cilës realizohen të ardhurat ose të jenë të lidhura me drejtimin normal të aktivitetit të tatimpaguesit;
- b. të jenë kryer ose të jenë përballuar efektivisht dhe të jenë të mbështetur në dokumente justifikuese të njohura ligjërisht;
- c. të jenë pasqyruar nëpërmjet një veprimi kontabël duke pakësuar aktivet neto; d. në çdo rast shpenzimet duhet të jenë të provuara nga tatimpaguesit me dokumentacionin përkatës ligjor.

Dokumente të përdorura si bazë për justifikimin e shpenzimit, për efekt tatimor, është fatura tatimore me TVSH, fatura e thjeshtë tatimore, faturat e leshuara nga persona jo-rezidentë që nuk janë të regjistruar në organet tatimore shqiptare dhe çdo dokument tjetër i lëshuar nga ente ose organizma juridike, Ambasada të huaja, organizma nderkombetare, zyra pune, komisaritate policie, muzete e institucioneve publike etj., për pagesat e tarifave të shërbimeve që këto ente i kryejnë tatimpaguesve, subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Degët e tatimeve mund të kërkojnë interpretimin me shkrim nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve lidhur me dokumenta të tjera të cilat nuk janë parashikuar në këtë udhëzim por që vërtetojnë shpenzime biznesore të subjektit.

- 17.** Cilat janë llojet e pagesave (të ardhura) për të cilat lind detyrimi për mbajtjen e tatimit në burim?

5 pikë

Përgjigje:

Të gjithë personat rezidentë në Republikën e Shqipërisë, organet e qeverisjes qendrore e vendore, organizatat jofitimprurëse dhe çdo subjekt tjetër, i njohur nga legjislacioni në fuqi,

janë të detyruar të mbajnë tatimin në burim në masën 15 për qind nga shuma bruto e pagesave të mëposhtme, që lindin nga një burim në Republikën e Shqipërisë, per:

- a) **dividendët;**
- b) **ndarjet e fitimit;**
- c) **interesat;**
- d) pagesat për **të drejtat e autorit** dhe për **pronësinë intelektuale;**
- e) pagesat për **shërbimet teknike, shërbimet e menaxhimit, shërbimet financiare** dhe ato **të sigurimit;**
- f) pagesat për menaxhimin dhe **pjesëmarrjen në këshillat drejtues;**
- g) pagesat për ndërtimin, instalimin, montimin ose për punë mbikqyrëse që lidhen me to
- h) **pagesat për qeratë;**
- i) **pagesat për shfaqjet e aktorëve, të muzikantëve ose sportistëve,** përfshirë pagesa të tilla që u bëhen personave, të cilët punësojnë artistë ose sportistë apo ndërmjetësojnë për shfaqje te tyre,
- j) të ardhurat e individëve nga **lojërat e fatit dhe kazinotë.**

- 18.** Shoqëria "alpha", që më datë 31.12.2016 rezulton me vlerë të kapitaleve të veta prej 20,000, ka realizuar të ardhura vjetore prej 1,000,000 lekë. Shoqëria ka paguar paradhënie të tatimit të fitimit të ushtrimit që sapo u mbyll për 40,000 lekë.

Shpenzimet e ushtrimit janë:

7 pikë

Paga	150,000
Sigurime	22,500
Mirëmbajtje	80,000
Energji elektrike	30,000
Shpenzime transporti	50,000
Te tjera administrative	40,000
Dhurata	35,000
Interes i paguar mbi huatë bankare	120,000
Gjoha, kamatvonesa	30,000

Për shoqërinë Alpha kërkohet:

- a) Fitimi ushtrimor para tatimit të fitimit;
- b) Llogaritja e shpenzimeve të panjohura;
- c) Llogaritja e tatimit mbi fitimin për vitin;
- d) Diferenca e tatimit të fitimit për tu paguar brenda datë 31.03.2017 me depozitimin e bilancit në tatime.

Norma e tatimit të fitimit është 15%.

Përgjigje:

a) Fitimi ushtrimor para tatimit

$$1,000,000 - 557,500 = 442,500 \text{ leke}$$

Te ardhura	1,000,000
Shuma e shpenzimeve	557,500
Paga	150,000
Sigurime	22,500
Mirmbajtje	80,000
Energji elektrike	30,000
Shpenzime transporti	50,000
Të tjera administrative	40,000
Dhurata	35,000
Interes i paguar mbi huatë bankare	120,000
Gjoha , kamatvonesa	30,000
Fitimi ushtrimor bruto	442,500

b) Llogaritja e shpenzime te panjohura

Në lidhje me fitimin fiskal dhe shpenzimet e panjohura:

Nëse gjatë periudhës tatimore, huaja dhe parapagimi tejkalojnë mesatarisht katër herë shumën e kapitaleve të veta, interesi i paguar për shumën e tejkaluar nuk njihet si shpenzim i zbritshëm.

Në rastin tonë :

Shpenzime për interesa: 120,000 lekë

Kapitalet e veta = 20,000 , pra limiti i njohjes së interesave është : $20.000 \cdot 4 = 80,000$ lekë.

Rrjedhimisht , 120,000 -80,000 lekë janë shpenzime të panjohura.

Dhuratat dhe gjobat janë shpenzime të panjohura.

Shpenzime të panjohura	105,000
Interes i paguar mbi huatë që tejkalon 4 herë vlerën e kapitaleve të veta	40,000
Dhurata	35,000
Gjoha , kamatvonesa	30,000

Llogaritja e tatimit mbi fitimin për vitin

Fitimi ushtrimor bruto	442,500
Shpenzime të panjohura	105,000
Interes i paguar mbi huatë që tejkalon 4 herë vlerën e kapitaleve të veta	40,000

Dhurata	35,000
Gjoha , kamatvonesa	30,000
Fitimi për efekt të tatimit të fitimit	547,500
Tatimi i fitimit (15%)	82,125
Fitimi pas tatimit të fitimit	360,375

Diferenca e tatimit të fitimit për tu paguar brenda datës 31/03/2017 me depozitim e bilancit në tatime

tatimi i fitimit (15%)	82,125
Paradhënie	40,000
Tatimi për tu paguar	42,125

Përmbledhje.

Të ardhura	1,000,000
Shuma e shpenzimeve	557,500
Paga	150,000
Sigurime	22,500
Mirmbajtje	80,000
Energji elektrike	30,000
Shpenzime transporti	50,000
Te tjera administrative	40,000
Dhurata	35,000
Interes i paguar mbi huatë bankare	120,000
Gjoha , kamatvonesa	30,000
Fitimi ushtrimor bruto	442,500
Shpenzime të panjohura	105,000
Interes i paguar mbi huatë që tejkalon 4 here vlerën e kapitaleve të veta	40,000
Dhurata	35,000
Gjoha , kamatvonesa	30,000
Fitimi për efekt të tatimit të fitimit	547,500
Tatimi i fitimit (15%)	82,125
Fitimi pas tatimit të fitimit	360,375
Paradhenje	40,000
Tatimi për tu paguar	42,125

19. Jepni përgjigje për pikat e mëposhtme:**6 pikë**

- a) Paraqisni në një tabelë shkallet e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi për nivelet e të ardhurave të përcaktuar në ligjin. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat
- b) Për listë pagesën e mëposhtme, llogarisni tatimin e të ardhurave nga punësimi:

Përshkrimi	paga bruto
Drejtor ekzekтив	160,000
Përgjegjës dega teknike	125,000
Ekonomist	75,000
Punetorë	30,000
Sanitare	27,000
TOTALI	417,000

- c) Në rast dypunësimi a ka një limit të sipërm në lidhje me bazën e tatueshme për efekt të tatimit të të ardhurave dhe në qoftë se po sa është ky limit ?

Përgjigje:

- a) Paraqisni në një tabelë shkallët e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi për nivelet e të ardhurave të përcaktuar në ligjin.8438, datë28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat

E ardhur e tatueshme			
Nga	deri	Përqindje	Përshkrim
zero	30,000	0%	zero perqind
30,001	130,000	13%	13% e shumës mbi 30.000 lekë
130,001	më tepër	23%	13.000 lekë + 23% e shumës mbi 130.000 lekë

b) për listë pagesën e mëposhtëme , llogarisni tatimin e të ardhurave nga punësimi:

		Përqindja			
Përshkrimi	Paga bruto	0%	13%	23%	TOTALI-
Drejt看 ekzekutiv	160,000	-	13,000	6,900	19,900
Pergjegjës dega teknike	125,000	-	12,350	-	12,350
Ekonomist	75,000	-	5,850	-	5,850
Punetore	30,000	-	-	-	-
Sanitare	27,000	-	-	-	-
TOTALI	417,000	-			38,100

c) Në rast dypunësimi a ka një limit të sipërm në lidhje me bazën e tatueshme për efekt të tatimit të të ardhurave dhe në qoftë se po sa është ky limit -1 pikë

Jo, nuk ka një limit të tillë për tatimin mbi të ardhurat nga punësimi,

Seksioni IV

Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

20. Importi i shërbimeve dhe autongarkesa e TVSH (VAT reverse charge). Kompania A, tatimpagues TVSH-je në Shqipëri, blen shërbime konsulence nga një kompani e huaj konsulente, tatimpaguese TVSH-je në Gjermani. Kompania Gjermane faturon çdo muaj sipas kontratës 10.000 euro. Çfarë veprimesh dhe deklarimesh duhet të bëjë kompania A çdo muaj për këto blerje për efekt TVSH-je?

5 pikë

Përgjigje:

Kompania A për vlerën e shërbimit të marrë sipas faturës lëshon një faturë tatimore në të cilën sillet sikur e ka kryer vetë shërbimin për vete, në mënyrë që të bëjë të mundur të ngarkojë me TVSH- në Shqipëri shërbimin e marrë.

Vlera e transaksionit llogaritet e konvertuar në monedhën shqiptare me kursin e ditës kur lëshohet fatura. P.sh. $10.000 \text{ euro} \times 125 \text{ leke/Euro} = 1.250.000 \text{ lekë} \times 20\% = 250.000 \text{ lekë}$ është vlera e TVSH-së.

Kjo faturë e lëshuar nga kompania A regjistrohet njëkohësisht në Librin e Blerjeve dhe në Librin e shitjevetë kompanisë A. Në faturë duhet të shkruhet “Auto-ngarkesë e TVSH-së”.

21. Çfarë pasqyron Libri i Blerjeve dhe Libri i Shitjeve i TVSH? Në cilat afate dhe në çmënyrë tatimpaguesi i TVSH i deklaron dhe raporton librat e TVSH?

5 pikë

Përgjigje:

Libri i Blerjeve përfaqëson listimin dhe përmbledhjen e të gjitha faturave tatimore për mallrat dhe shërbimet e blera nga tatimpaguesi dhe Libri i Shitjeve përfaqëson listimin dhe përmbledhjen e të gjitha faturave për mallrat dhe shërbimet e kryera nga tatimpaguesi gjatë zhvillimit të aktivitetit të tij tregtar.

Subjektet (tatimpaguesit) me xhiro mbi 5 milionë lekë, kanë detyrimin për plotësimin dhe dorëzimin e librave të blerjeve dhe shitjeve çdo datë 10 të muajit pasardhës.

Për subjektet me xhiro 2-5 milion, detyrimi për dorëzimin e librave është data 10 e tremujorit pasardhës.

22. Shoqëria A (tatimpagues tvsh-je) ka kryer veprimet e mëposhtëme gjatë muajit Janar 2018:

7 pikë

- ka pranuar fatura blerje malli, me tvsh të zbritshme, me vlerë pa tvsh 150.000 lekë;
- ka pranuar fatura karburanti për autovetura, me vlerë me tvsh 60.000 lekë;

- ka pranuar një faturë me tvsh nga një restorant për një drekë biznesi me vlerë me tvsh 30.000 lekë;
- ka pranuar fatura blerje nga tatimpagues të biznesit të vogël (fatura të thjeshta tatimore), me vlerë totale 40.000 lekë;
- ka lëshuar fatura shitje me tvsh, me vlerë totale 300.000 lekë,
- ka eksportuar mallra me vlerë doganore në eksport 100.000 lekë;
- Ka lëshuar një faturë shërbimi për një klient të huaj (tatimpagues TVSH-je në Gjermani) në vlerën 50.000 lekë.

Kërkohet:

- Të përcaktohet shuma e TVSH-së së llogaritur për muajin Janar 2018;
- Të përcaktohet shuma e TVSH-së së zbritshme për muajin Janar 2018;
- Të përcaktohet shuma e TVSH-së së pagueshme për muajin Janar 2018, kur dihet se muaji Dhjetor 2017 është mbyllur me një tepricë kreditore prej 10.000 lekë.

Përgjigje:

- TVSH-ja e llogaritur për muajin Janar është: 50.000 lekë ($300.000 : 6 = 50.000$). Vlera e eksportit dhe fatura për shërbimin në Gjermani do të jetë me TVSH 0%;
- TVSH-ja e zbritshme për muajin Janar është: 30.000 lekë ($150.000 \times 20\% = 30.000$);
- TVSH e pagueshme për muajin Janar është: $50.000 - 30.000 - 10.000 = \mathbf{10.000 \text{ lekë}}$.

23. Bashkia e Qytetit Tiranë ka marrë një financim nga një donator i huaj për projektin e rikonstruksionit të një shkolle publike. Vlera e preventivit të hartuar është 30.000.000 lekë dhe TVSH 20% 6.000.000 lekë. Donatori i huaj nuk pranon të financojë vlerën e TVSH-së (6.000.000 lekë). Pra vlera e financimit që merr Bashkia nga donatori i huaj për këtë rikonstruksion shkolle është 30.000.000 leke.

Shoqëria ndërtuese “D” (tatimpagues TVSH-je) e kontraktuar nga Bashkia kryen rikonstruksionin e shkollës për një periudhë 3 mujore dhe lëshon çdo muaj faturë tatimore për Bashkinë (me vlerë pa TVSH 10.000.000 lekë), bazuar në situacionin e punimeve që është në përputhje të plotë me preventivin.

6 pikë

Kërkohet:

- A duhet të llogarisë TVSH në shitje shoqëria ndërtuese “D” çdo muaj dhe a duhet ta paguajë këtë TVSH?
- Duke qenë se donatori i huaj nuk e paguan TVSH-në, kush duhet ta parashikojë dhe përballojë TVSH prej 6.000.000 lekë?

Përgjigje:

- a) Shoqëria Ndërtuese D duhet të llogarisë TVSH për çdo faturë të bazuar në situacionin mujor të punimeve. Pra fatura që do të lëshohet çdo muaj për Bashkinë Tiranë është $10.000.000 + 2.000.000 \text{ (TVSH)} = 12.000.000$ lekë;
- b) TVSH prej 6.000.000 duhet të përballohet nga Bashkia Tiranë si kosto lokale për zbatimin e këtij projekti.

Seksioni V

Taksat Vendore Direkte

24. Cilat janë parimet bazë të funksionimit të sistemit të taksave e tarifave vendore dhe të administratës së taksave vendore? **4 pikë**

Përgjigje:

Sistemi i Taksave vendore duhet t'i përgjigjet disa parimeve gjate funksionimit:

- Parimit **të ligjshmërisë**, sipas të cilit rregullat, vlerat dhe mënyrat e mbledhjes së tatimeve e taksave të të gjitha llojeve duhet të fiksohen nëpërmjet ligjit, domethënë të votohen në parlament.
- Parimit **vjetor**, sipas të cilit njesite vendore duhet t'i mbledhin taksat vendore cdo vit.
- Parimit **të barazisë**, sipas të cilit kontributi i përbashkët i mbledhur duhet të jetë gjithashtu i shpërndarë midis qytetarëve për shkak të mundësive të tyre.
- Parimit **të nevojës**. Sipas të cilit për një periudhë të caktuar për shkak të nevojave të komunitetit mund të vendosen taksa të perkohshme.
- Parimit **zhvillimit dhe perkrahjes**. Sipas të cilit për disa biznese dhe shtresa të ndryshme behen percaktime të ndryshme të nivelit të taksave (ulje/ngritje brenda limiteve të ligjit).

Administrata e taksave vendore ka në bazë të funksionimit të saj këto parime:

- Parimi i **transparencës**: administrata e taksave vendore, duhet të jetë sa më transparente për publikun, në të gjitha vendimet apo veprimet që ndërmerr.
- Parimi i **barazisë së taksapaguesve**: të gjithë qytetarët dhe bizneset trajtohen në mënyrë të barabartë, pavarësisht gjinisë, arsimit, etnisë, gjendjes ekonomike e sociale, bindjeve politike e fetare etj.
- Parimi i **ligjshmërisë**: të gjithë punonjësit gjatë ushtrimit të detyrave të tyre për përmbushjen e funksioneve të taksave e tarifave vendore janë të detyruar të zbatojnë Kushtetutën dhe të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Askujt nuk i lejohet shmangia nga detyrimet ligjore, moszbatimi i ligjit apo zbatimi i gabuar i tij, për shkak të padijenisë së ligjit.
- Parimi i **ndershmërisë**: të gjithë nëpunësit dhe punonjësit detyrohen të trajtojnë në mënyrë të ndershme dhe të paanshme të gjithë qytetarët dhe subjektet me të cilët hyjnë në marrëdhënie për shkak të detyrave apo kompetencave të tyre, duke zbatuar me rigorozitet parimet e etikës në administratën publike.
- Parimi i **efektivitetit dhe produktivitetit në punë**: të gjithë punonjësit gjatë ushtrimit të detyrave të tyre ndermarrin veprime, reale, të shpejta, konkrete, të efekshme dhe produktive.

- **Parimi i besimit dhe mbështetjes tek tatimpaguesit:** i gjithë sistemi të bazohet në rritjen e besimit tek tatimpaguesit, nepermjet nxitjes së tyre për informim dhe pagesa vullnetare, por duke reaguar ndaj problemeve të tyre përmes nxitjes së kultures së respektit reciprok.
- Parimi i **bashkëpunimit:** të gjithë strukturat nëpunësit dhe punonjësit duhet të sigurojnë bashkëpunimin për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta.
- Parimi i **llogaridhenies:** të gjithë strukturat nëpunësit dhe punonjësit japin llogari sipas hierarkisë dhe jo vetëm, për detyrat dhe përgjegjësitë e tyre.
- Parimi i **vazhdimësisë:** detyrat e ndjekura nga nëpunësit e mëparshëm, që janë larguar nga detyra, do të vazhdojnë të realizohen nga nëpunësit e rinj.
- Parimi i **ndalimit të konfliktit të interesave:** asnjë punonjës i taksave vendore në nivel drejtues, nuk mund të jetë pjesë e një procesi vendimmarrës, nëse kjo ndalohet nga dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative dhe ligji për konfliktin e interesit.

Seksioni VI

Akcizat dhe Taksat Doganore

- 25.** Përse është e nevojshme të deklarohen vlerat monetare në kufi, cilat janë penalitetet e mosdeklarimit dhe si kryhet deklarimi? **4 pikë**

Përgjigje:

Deklarimi i vlerave monetare në kufi lidhet me:

- ✓ parandalimin e pastrimit të parasë;
- ✓ financimin e terrorizmit.

Çdo person, shqiptar ose i huaj, i cili hyn ose largohet në dhe nga territori i Republikës së Shqipërisë është i detyruar të deklarojë shumat në të holla, çdo lloj instrumenti të negociueshëm, metalet ose gurët e çmuar, sendet me vlerë dhe objektet antike, duke filluar nga shuma 1,000,000 (një milion lekë) ose kundërvlera e saj në monedha të tjera të huaja, si dhe qëllimin e mbartjes së tyre, për të cilat duhet të paraqesë dokumente justifikuese.

Cilat janë penalitetet e mosdeklarimit?

Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë, në hyrje ose dalje nga territori i Republikës së Shqipërisë, i shumave në të holla, i çdo lloj forme të çekut bankar, metaleve ose gurëve të çmuar, si dhe i sendeve të tjera me vlerë, përtej vlerës së parashikuar nga ligji përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

Si kryhet deklarimi?

Deklarimi kryhet nëpërmjet formularit për raportimin e transportit të vlerave në kufi (RTVK) i cili gjëndet pranë zyrave doganore në Pikat e Kalimit Kufitar ose mund të shkarkohet nga faqja web e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave

Seksioni VII

Kontributet e detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore

26. Individi A, nga Janari 2018 është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKB) dhe në Drejtorinë rajonale Tatimore Tiranë si person fizik i vetë-punësuar si konsulent i pavarur. Më datën 1 Qershor 2018, ky individ gjithashtu është punësuar pranë kompanisë X dhe përfiton një pagë bruto mujore sipas kontratës së punës prej 200.000 lekë.

5 pikë

Kërkohe:

- (a) Llogarisni detyrimet për kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore që Individi A duhet të paguajë si person fizik i vetë punësuar (pa të punësuar të tjerë) për tremujorin e dytë 2018.
- (b) Llogarisni detyrimet për kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore që shoqëria X duhet të paguajë për Individin A për muajin Qershor 2018 (përfshirë pjesën e punëmarrësit dhe të punëdhënësit).

Përgjigje:

- a) Detyrimet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore për Personin Fizik A për tremujorin e dytë 2018 janë në shumën 15.936 leke. Llogaritja bëhet si vijon:
- Për secilin muaj Prill dhe Maj 2018, detyrimi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore për Personin Fizik llogaritet si vijon:
 - Kontribute sigurime shoqërore = $24.000 \times 23\% = 5.520$ leke
 - Kontribute për sigurime shëndetësore = $48.000 \times 3.4\% = 1.632$ leke
 - Totali muajor = 7.152 lekë
 - Totali Prill, Maj = $7.152 \times 2 = 14.304$ leke.
 - Për Qershorin 2018, për Personin Fizik, llogariten dhe paguhen vetëm sigurime shëndetësore në shumën: $48.000 \times 3.4\% = 1.632$ leke, sepse për muajin Qershor sigurimet shoqërore paguhen për nivelin maksimal të pages tek kompania X.
 - Në përfundim, për tremujorin e dytë 2018 paguhen 2 muaj (Prill, Maj) sigurime shoqërore dhe shëndetësore në shumën 14.304 leke dhe për Qershorin vetëm sigurime shëndetësore në shumën 1.632 leke. Pra në total sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për Personin Fizik për tremujorin e dytë 2018 janë: $14.304 + 1.632 = 15.936$ leke.

b) Detyrimi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore tek kompania A është 32.734 lekë. Llogaritja behet si vijon:

- Kontribute për sigurime shoqërore nga punedhenesi: (15% mbi pagën maksimale) = $105.850 \times 15\% = 15.878$ lekë;
- Kontribute për sigurime shoqërore nga punedhemarrësi (9.5% mbi pagën maksimale) = $105.850 \times 9.5\% = 10.056$ lekë;
- Kontribute për sigurime shëndetësore punedhenesi/punedhemarrësi (3.4% pa kufi maksimal pagë) = $200.000 \times 3.4\% = 6.800$ lekë.

Pra në total detyrimi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore që shoqëria X do të paguajë për punëmarrësin A për muajin Qershor 2018 është $15.878 + 10.056 + 6.800 = 32.734$ leke.

27. Një punonjëse e kompanisë A e ka pagën bruto mujore 300.000 lekë. Gjatë muajit Maj 2018, punonjësja nuk është paraqitur në punë për 15 ditë pune dhe ka paraqitur raport mjekësor. Muaji Maj 2018 ka 23 ditë pune.

4 pikë

Kërkohet: Llogarisni detyrimin e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore të kompanisë për këtë punonjëse për muajin Maj 2018, përfshirë pjesën e punëmarrësit dhe atë të punëdhënësit.

Përgjigje:

Detyrimi për sigurime shoqërore dhe shëndetësore tek kompania A është 34.448 lekë. Llogaritja behet si vijon:

Llogaritja e pagës bruto për muajin Maj:

- Paga ditore e punonjësit = $300.000 \text{ lekë} / 23 \text{ ditë} = 13.043$ lekë;
- Ditë me raport të mbuluar nga punëdhësi 14 ditë = $14 \times 80\% \times 13.043 \text{ lekë} = 146.082$ lekë;
- Ditë me raport të mbuluara nga Instituti i Sigurime Shoqërore 1 ditë.
- Ditë të punuara gjatë muajit Maj 8 ditë = $8 \times 13.043 \text{ lekë} = 104.344$ lekë.
- Paga Bruto për muajin Maj 2018 = 250.426 leke.

Llogaritja e kontributeve për sigurime shoqërore dhe shëndetësore që do të paguhet nga kompania A për këtë punonjëse:

- Kontribute për sigurime shoqërore punedhenesi (15% mbi pagën maksimale) = $105.850 \times 15\% = 15.878$ lekë.
- Kontribute për sigurime shoqërore punëmarrësi (9.5% mbi pagën maksimale) = $105.850 \times 9.5\% = 10.056$ lekë.
- Kontribute për sigurime shëndetësore punedhenesi dhe punedhemarrësi (3.4% pa kufi pagë) = $250.426 \text{ lekë} \times 3.4\% = 8.514$ lekë.
- Gjithsej kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore = $15.878 + 10.056 + 8.514 = 34.448$ lekë.